



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**VENDIM**

**Nr. 248, datë 21.12. 2016**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË SEKRETARIATIT TEKNIK  
DHE PËRCAKTIMIN E MASËS SË PAGESËS PËR PJESËMARRJE NË SEKRETARIATIN TEKNIK**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 16 dhe 18, nenit 23 pika 2 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe nenit 27 të Rregullores së Autoritetit të Medias Audiovizive miratuar me vendimin nr. 209, datë 16.09.2016, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Sekretariatit Teknik", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Përcaktimin e masës së pagesës për pjesëmarrje në Sekretariatit Teknik në shumën prej 15.000 lekë për mbledhje.
3. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>Kryetar:</b>	<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>
<b>Zëvendëskryetar:</b>	<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>
<b>Anëtarë:</b>	<b>Agron</b>	<b>GJEKMARKAJ</b>
	<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>
	<b>Piro</b>	<b>MISHA</b>
	<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>
	<b>Zylyftar</b>	<b>BREGU</b>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**RREGULLORE MBI ORGAZINIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SEKRETARIATIT TEKNIK**

**Neni 1**  
**Objekti**

Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave të organizimit dhe të funksionimit të Sekretariatit Teknik të Autoritet të Mediave Audiovizive.

**Neni 2**  
**Baza Ligjore**

1. Sekretariati Teknik krijohet dhe funksionon në bazë të Rregullores së Autoritet të Mediave Audiovizive miratuar me vendimin nr. 209, datë 16.09.2016.
2. Sekretariati Teknik në ushtrim të funksioni të tij zbaton dispozitat e ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kodit të Procedurave Administrative dhe çdo akti tjetër ligjor e nënligjor që nuk bie ndesh me ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

**Neni 3**  
**Qëllimi**

Sekretariati Teknik ka qëllim që nëpërpjet veprimtarisë së tij, të sigurojë mirëorganizimin dhe mbarëvajtjen e mbledhjeve të Autoritet të Mediave Audiovizive, në përmbushje të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ligji për mediat audiovizive, rregullorja për Autoritetin e Mediave Audiovizive dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fushën e mediave audiovizive

**Neni 4**  
**Përbërja**

Sekretariati Teknik përbëhet nga:

1. Sekretari i Përgjithshëm i cili drejton dhe mbikqyrë punën e Sekretariat Teknik.
2. Dy nëpunës të administratës të caktuar me urdhër prej Sekretarit të Përgjithshëm.

**Neni 5**  
**Detyrat funksionale të sekretariatit teknik**

1. Sekretariati teknik ndihmon AMA në ushtrimin e veprimtarisë së tij:
  - a) duke krijuar kushtet e nevojshme për realizimin dhe mbarëvajtjen e mbledhjes;
  - b) duke përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes;
  - c) duke përcjellë njoftime për anëtarët e AMA;
  - d) duke kryer çdo detyrë tjetër në kuadër të asistencës për organizimin e mbledhjes së AMA në lidhje me çështje që përfshihen në fushën e veprimtarisë së tij.
2. Në veçanti sekretariati teknik ushtron këto funksione:

- a. mbledh, përgatit, administron dhe i vë në dispozicion anëtarëve të AMA të gjithë dokumentacionin dhe materialet e nevojshme për çështjet që shqyrtohen në mbledhjet e tij;
- b. komunikon me shkrim njoftimin për thirrjen e mbledhjes të Autoritetit të Mediave Audiovizive të gjithë anëtarëve të AMA jo më vonë se 48 orë përpara datës dhe kohës së vendosur për mbajtjen e mbledhjes. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes duhet të përcaktojë datën, vendin dhe orën e zhvillimit të saj, si dhe të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet;
- c. njofton anëtarët e AMA, për çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet.
- d. koordinon punën me strukturat përgjegjëse të administratës dhe Këshillit të Ankesave për përgatitjen e projektvendimeve dhe dokumentacionit shoqërues sipas standardeve dhe formatit të miratuar.
- e. mban procesverbalin e mbledhjeve të AMA në përputhje me kërkesat e nenit 28 të Rregullores së Autoritetit të Mediave Audiovizive;
- f. komunikon vendimet e marra në mbledhjet e AMA subjekteve dhe strukturave përkatës;
- g. regjistron, publikon dhe arkivon vendimet dhe dosjen me dokumentacionin e shqyrtuar në mbledhjen e AMA, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- h. zbaton urdhrat dhe porositë e Kryetarit apo anëtarëve të AMA

## **Neni 6**

### **Raportimi pranë Sekretariatit Teknik**

1. Drejtoritë e administratës së AMA dhe Këshilli i Ankesave dërgojnë informacion pranë Sekretariatit Teknik mbi çështjet që trajtojnë në përmbushje të funksioneve dhe kompetencave të tyre, të cilat kërkojnë vendimmarrje apo mendime në mbledhjet e AMA.
2. Dërgimi i informacionit bëhet mbi kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm, por jo më vonë se data 1 dhe 15 i çdo muaji, në formë elektronike në formatet e miratuara, ose në përputhje me përmbajtjen e kërkesës së parashtruar.

## **Neni 7**

### **Hyrja në fuqi**

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në përputhje me ligjin nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë".